



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 3 prot.

Kamëz, më 22.01. 2024

V E N D I M

Nr. 03 Datë 22.01 / 2024

MBI

“MIRATIMIN E KALIMIT NË STRUKTURËN E RE ORGANIZATIVE NË NIVEL DREJTORIE SI DHE PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.93 Datë 21.12.2023 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 shkronja “ç”, nenin 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronja “d”, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; të vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkaikë”, datë 22.12.2022, vendimit nr.103, datë 18.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2024”, si dhe në vijim të shkresës 7618/1 datë 16.10.2023, të Policisë Bashkiake, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e kalimit në strukturën e re organizative në nivel drejtorie.
2. Përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë Kamëz, sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në Janar të vitit 2024 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë për vitin 2024.
4. Çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij vendimi shfuqizohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Policia Bashkiake.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

